


Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24.02.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ahmet Krasniqi Menaxher i Zyrës së Prokurimit Komuna e Prizrenit.
CC:	z. Ramadan Muja Kryetar i Komunës e Prizrenit.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Transportimi i mësimdhënësve në Komunën e Prizrenit".



I nderuari z. Krasniqi

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Transportimi i mësimdhënësve në Komunën e Prizrenit". numri prokurimit 622-12-010-211 ofron këtë:

### OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit- Komuna e Prizrenit t' i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetimin, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

### Arsyetim

Zyra e prokurimit në Komunën e Prizrenit, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime " të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 622-12-010-211 me titull "Transportimi i mësimdhënësve në Komunën e Prizrenit" , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e

të dhënave të tenderit në dosjen e tenderit te kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 2 dokumentet e kërkuara - ka kërkuar , veç tjerash, numri e relacioneve të udhëtimit.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të tenderit ekonomikisht më të favorshëm, ku ka paraparë: “numri i vijave të udhëtimit “si nen kriter është 40 poenë.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- **Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042 .**

Zyra e prokurimit gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit te pjesa II . përshkrimi i çmimeve nuk është përpiluar sipas rregullave për specifikimeve teknike dhe dosjen e tenderit . Autoriteti Kontraktues u ka dorëzuar Operatorëve Ekonomik kërkesën e njësisë shpenzuese ashtu si është dorëzuar nga Drejtoria e Arsimit në zyrën prokurimit , gjë që është në kundërshtim me nenin 27 LPP-së04/L-042

Me respekt!